Buxheti në vetvete është një raport balancues midis të ardhurave dhe shpenzimeve që janë përdorur në interes të qytetarëve lushnjarë dhe që kanë t bëjnë me punime të ndërtimit, rehabilitimit dhe mirëmbajtjes së rrugëve, zgjerimin e rrjetit të ndriçimit në mjediseve publike dhe mirëmbajtjen e tij rritjen dhe mirëmbajtjen e sipërfaqeve të gjelbëruara, pastrimin dhe përpunimin e mbeturinave urbane, administrimin dhe mirëmbajtjen e varrezav publike, ruajtjen dhe zhvillimin e vlerave kulturore e artistike, në zhvillimin e sporteve, në shërbimin social, në mirëmbajtjen e çerdhe-kopshteve s dhe shkollave, në rehabilitimin e kanaleve dhe tregjeve publike, në mbështetjen dhe nxitjen e biznesit të qytetit.

***Objektivat strategjikë nga të cilat Administrata Tatimore Vendore udhëhiqet janë:***

1. Garantimi i asistencës për përmbushjen vullnetare, përmes:

- ofrimit të shërbimeve cilësore dhe reduktimit të barrës administrative në pagesën e detyrimeve tatimore dhe kontributeve shoqërore.
- rritjes së ndërgjegjësimit publik duke ndihmuar në zhvillimin e kulturës për përmbushje vullnetare më të lartë dhe kuptimin e rolit t Administratës Tatimore në shoqëri.

2. Zbatimi efikas i legjislacionit tatimor, sigurimeve shoqërore dhe hetimi i rasteve të mashtrimit tatimor, përmes:

- zbatimit të strategjisë së përmbushjes së menaxhimit të riskut
- përmirësimit të mëtejshëm të kontrollit tatimor dhe gjurmimit të mashtrimeve tatimore mbledhjes efikase të borxhit

3. Progresi organizativ i Administratës Tatimore Vendore dhe zhvillimi i kapaciteteve njerëzore, përmes:

- aplikimit të metodave dhe sistemeve për të menaxhuar një adminsitratë tatimore moderme
- zhvillimit të kapaciteteve dhe motivimit të punonjësve
- mbajtjes së proceseve optimale dhe strukturës së Administratës Tatimore
- zhvillimit dhe përmirësimit të partneriteteve

- modernizimit dhe rinovimit të infrastrukturës
- ka një rritje cilësore të komunikimit me administratën tatimore, në raport me gjetjet e vitit 2019-2022


  (transparencën, komunikimin me biznesin, aksesin në kohë dhe cilësinë e informacionit),
- Përmirësimit të komunikimit dhe shërbimet ndaj tatimpaguesve në periudhën 2023
- rritjes së cilësisë së shërbimeve elektronike të taksave që është dukshëm më e lartë në 2023, në të gjitha aspektet e vlerësuara, si : aksesi besueshmëria dhe saktësia e përpunimit të të dhënave
- rritjes së konsiderueshme në vlerësimin për cilësinë e raportit të auditimit, si dhe sjelljen e etikën e inspektorëve
- rritjes së ndjeshme të ndërgjegjësimit të tatimpaguesve për Modulin e Analizës së Riskut dhe përzgjedhjen për inspektimet bazuar në të.

**E drejta e autorit © 2025. Drejtoria e të Ardhurave Vendore Bashkia Lushnje. Të gjitha të drejtat e rezervuara. Përveç për citim t fragmenteve të shkurtra për qëllim të kritikës dhe kontrollimit, asnjë pjesë e këtij publikimi nuk mund të riprodhohet, ruhet në sistem k mund të përdoret serish, apo transmetohet në çfarëdo forme apo përmes çfarëdo mjeti elektronik, mekanik, fotokopjohet, incizohet apo tjera pa lejen paraprake të Drejtorisë të Ardhurave Vendore Bashkia Lushnje.**

Raporti vjetor i Drejtorisë të Ardhurave Vendore është një dokument publik i cili ngarkohet në faqen zyrtare të internetit www.bashkialushnje.gov.a

## Struktura


### ORGANIGRAMA Drejtoria e të Ardhurave Vendore



## Ç'FARË JANE TAKSAT DHE TATIMET DHE KU DALLOJNË ?

Taksat dhe tatimet janë detyrime financiare të përcaktuara me ligj, që kontribuojnë në mbushjen e buxhetit të një shteti dhe si të tilla përbëjnë burimi kryesor të të ardhurave buxhetore. Në baza të përditshme, fjala 'tatim' përdoret si sinonim i fjalës 'taksë' apo anasjelltas. Një praktikë e tillë nuk hase vetëm në diskursin e popullit, por edhe në atë të medias, shoqërisë civile e politikanëve. Në të vërtetë, në biseda të përditshme, këto dy terma mun t'i përdorim sikur të kishin kuptimin e njëjtë, mirëpo dallimi mes tyre është substancial. Taksat dhe tatimet dallojnë për nga përkufizimi, qëllimi dh natyra e tyre.

**Figura 1. Dallimi midis takses dhe tarifes**



## PARIMET E VENDOSJES SË TAKSAVE DHE TARIFAVE

Para se të hyjmë më thellë në shtjellimin e problemit kyç që adreson kjo analizë, po paraqesim një pasqyrë më të qartë për të kuptuar më mirë natyrë e taksave dhe tarifave vendore. Në parim, tatimet /taksat dhe tarifat ndahen në dy grupe, në ato direkte, ku përfshihen tatimi në të ardhura, tatimi thjeshtuar mbi fitimin per biznesin e vogel ,taksa e nderteses, etj., dhe ato indirekte, të cilat i paguajmë përmes ofrimit të shërbimeve publike t ndryshme. Në këtë kategori bëjnë pjesë, tarifa e pastrimit,ndrcimit,gjelberimit, tarifa e zenies se hapesires publike, tarifa per parkim, etj. Niveli taksave dhe tarifave vendore mund të përcaktohet në disa mënyra, duke marrë parasysh parimet e më poshtëme:





**Figura 2. Parimet per vendosjen e taksave dhe tarifave**

## I .Parashikimi dhe Realizimi i të Ardhurave të Bashkisë Lushnje për Vitin 2025

Parashikimi i të ardhurave për vitin 2025 është mbështetur në realizimin e pritshëm të të ardhurave të viteve të mëparshme dhe njëkohësisht në paketa fiskale të hartuar nga Bashkia Lushnje, tarifat e miratuara gjatë vitit 2025, nga Këshilli i Bashkisë Lushnje, dhe rritja e performancës në mbledhjen taksave dhe tarifave vendore.

Gjithashtu rritja e të ardhurave të parashikuara në vitin 2025, është mbështetur, kryesisht në zgjerimin e bazës së tatimpaguesve në gjithë territorin Bashkisë Lushnje, në punën e madhe dhe zbatimin me rigorozitet të procedurave për mbledhjen e taksave nga çdo qytetar apo biznes dhe jo në rritje e vlerës së taksave dhe tarifave.

Në total duke përfshirë dhe transfertat, të ardhurat e planifikuara dhe të realizuara në mënyrë të përmbledhur për vitin 2025 jepen në pasqyrën mëposhtme:


**Realizimi i të ardhurave për vitin 2025**

**në '000 lekë**

| Nr. | Institucioni | Plani Vjetor 2025 | Totali 12/mujor i te ardhurave | | % |
|---|---|---|---|---|---|
| | | | Plan | Fakt | |
| 1 | Te ardhura e vitit 2025 | 640,579 | 640,579 | 513,893 | 80.2 |
| 2 | Te ardhurat e trasheguara v.2024 | 445,710 | 445,710 | 566,697 | 127.1 |
| 3 | Transf. pa kushtezuar v.2025 | 684,949 | 684,949 | 684,949 | 100.0 |
| 4 | Transf pak.sektoriale v.2025 | 398,124 | 398,124 | 398,124 | 100.0 |
| | Shtesa transferta te tjera gjate vitit | 28,930 | 28,930 | 28,930.38 | 100 |
| | **Shuma** | **2,198,292** | **2,198,292** | **2,192,593** | **99.7** |

Siç shihet edhe nga tabela e mësipërme, në total të ardhurat e bashkisë për vitin 2025 janë realizuar 2,192,593,000 lekë nga 2,198,292,000 lekë planifikuara ose 99.7% e planit vjetor. Në 24.12.2025 është dërguar shkresa për shtesë nga transferta e përgjithshme e pakushtezuar në vlerë 24,014,201 lekë si dhe shtesa nga grandi i bazuar në performancë në vlerën 3,056,180 lekë. Këto të ardhura janë përfshire në planin e vitit 2025 n Degen e Thesarit dhë janë miratuar në janar të vitit 2026 sipas VKB nr 13 datë 22.01.2026 dhe VKB nr 14 datë 22.01.2026 përpercaktimin destinacionit sipas programeve të shpenzimeve.Vlera torale e këtyre dy transfertave nuk është e përfshirë në planin vjetor 2025 në Degën e Thesarit

***Në mënyrë grafike realizimi i të ardhurave është:***




Realizimi i transfertës së pakushtëzuar dhe i transfertës specifike të marra së bashku është në nivelet 100 %. Një pjesë e tyre që ka qenë gjendje n llogaritë e veçanta të shpenzimeve është trashëguar për në fillimin e vitit 2025. Plani i transfertave (grandeve) është i ndarë në tremujorë, aq sa ësh dhe përcaktimi në mbështetje të Udhëzimit Plotësues përkatës, sipas të cilit çeljet e transfertave të pakushtëzuara dhe të transfertës së pakushtëzua sektoriale bëhen 30% në tremujorin e parë, 25% në tremujorin e dytë, 23% në tremujorin e tretë dhe 22% e vlerës së përgjithshme çelet në tremujori e katërt.

Realizimi i të ardhurave të trashëguara është në vlerën e 566,697,000 lekë nga të cilat janë shpërndarë 445,710,000 lekë gjatë vitit 2025. Për këtë vle bëhet edhe rakordim me Degën e Thesarit.

Analiza për realizimin e hollësishëm të ardhurave të vetë Bashkisë është bërë në vazhdim. Në total të ardhurat që i takojnë sipas planifikimit vetë Bashkisë në vitin 2025 janë realizuar 494,407,000 lekë nga 613,839,000 lekë të planifikuara ose 80.84%. . Në vitin 2024 janë realizuar 501,517,00 lekë nga 613,839,000 lekë të planifikuara ose 81.7%. Në vitin 2023 janë realizuar 471,778,000 lekë nga 586,560,000 lekë të planifikuara ose 80.48%

Në vitin 2022 janë realizuar 421,316,000 lekë nga 584,160,000 lekë të planifikuara ose 72.12%. Viti 2021 ishte me realizim 403,795,000 lekë ng 584,007,000 lekë të planifikuara ose 69,1%. Viti 2020 ishte me realizim 401,805,000 lekë nga 590,367,000 lekë të planifikuara ose 68.1%. Në viti 2019 ky realizim ishte 382,341,000 lekë nga 585,823,000 lekë të planifikuara ose 65.3 %, pra në rritje nga viti në vit.
Të ardhurat e realizuara nga Qendra e Arsimit për kopshte, çerdhe, konvikte, etj. Për vitin 2025 janë realizuar në masën 13,332,000 lekë nga 12,240,00 lekë të planifikuara ose 107.89%,
Për vitin 2024 janë realizuar në masën 13,206,000 lekë nga 12,240,000 lekë të planifikuara ose 107.89%, për vitin 2023 janë realizuar në masë 9,664,000 lekë nga 12,240,000 lekë të planifikuara ose 78.95%, për vitin 2022 janë realizuar në masën 9,489,000 lekë, nga 12,240,000 lekë t planifikuara ose 77.52 %. Për vitin 2021 janë realizuar në masën 8,923,000 lekë nga 12,220,000 lekë të planifikuara ose 73 %. Për vitin 2020 realizim ishte 6,053,000 lekë nga 12,200,000 lekë të planifikuara ose 49.6 %, (vit i cili pati ndikim të madh nga pandemia).

Të ardhurat e realizuara nga Ndërmarrja e Pasurisë Publike për vitin 2025 janë 6,131,000 lekë nga 13,000,000 lekë të planifikuara ose 47.16%. Pë vitin 2024 janë 5,760,000 lekë nga 13,000,000 lekë të planifikuara ose 44.31%. Për vitin 2023 janë 6,299 ,000 lekë nga 13,000 ,000 lekë të planifikuar ose 48.45%. Për vitin 2022 janë realizuar 6,539 ,000 lekë nga 13,000 ,000 lekë të planifikuara ose 50.3%. Për vitin 2021 realizimi ishte 6,526 ,00 lekë nga 13,000 ,000 lekë të planifikuara ose 50.2 %. Për vitin 2020 realizimi ishte 5,891 ,000 lekë nga 13,000 ,000 lekë të planifikuara ose 45.3 %.

Të ardhurat e realizuara nga Qendra e Kulturës për vitin 2025 janë vetëm 23,700 lekë nga 1,500,000 lekë ose 1.58%. Për vitin 2024 janë vetëm 57,00 lekë nga 1,500,000 lekë ose 3.81%. Për vitin 2023 janë vetëm 50,000 lekë nga 1,500,000 lekë ose 3.33%, për vitin 2022 janë realizuar vetëm 28,00 lekë nga 1,500,000 lekë të planifikuara ose 1.86 %. me rritje krahasuar me vitin 2021, ku realizimi ishte 6,000 lekë nga 1,500,000 lekë të planifikuara
Realizimi më i detajuar i të ardhurave vendore paraqitet në tabelën në vijim.

# PARASHIKIMI DHE REALIZIMI I TË ARDHURAVE PËR VITIN 2025

*në '000 lekë*


| Nr. | Lloji i të Ardhurave | Plani Vjetor 2025 | Progresiv 12-mujori 2025 | |
|---|---|---|---|---|
| | | | Plan | Fakt |
| | **Bashkia** | | | |
| I | **Të ardhura të taksueshme** | | | |
| 1 | Taksë mbi ndërtesat | 97,000 | 97,000 | 86,019 |
| 2 | Taksë mbi tokën bujqësore | 100,000 | 100,000 | 65,640 |
| 3 | Taksë mbi truallin | 20,400 | 20,400 | 20,257 |
| 4 | Taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja | 70,300 | 70,300 | 35,250 |
| 5 | Taksa mbi veprimtarinë e shërbimit hotelier | 180 | 180 | 531 |
| 6 | Taksa vendore e tabeles ^ Takse Reklame | 10,000 | 10,000 | 14,135 |
| 7 | Taksë mbi veprimtarinë e Bizn.Vogël(Tatim i thjeshtuar mbi fitimin) | - | - | 439 |
| 8 | Tarifa për leje transporti&license | 5,030 | 5,030 | 3,900 |
| | **Shuma I** | **302,910** | **302,910** | **226,172** |
| II | **Taksa të ndara** | | - | - |
| 1 | Taksa e kalimit të drejt së pronësisë të pas. paluajt | 10,000 | 10,000 | 5,970 |
| 2 | Taksa për qarkullimin e mjeteve të përdorura | 36,000 | 36,000 | 59,414 |
| 3 | Renta minerare | 6,900 | 6,900 | 3,701 |
| 4 | Nga tatimi mbi të ardhurat personale | 14,000 | 14,000 | 45,098 |
| 5 | Transfertë nga MIE | | - | - |
| | ***Shuma II*** | ***66,900*** | **66,900** | **114,183** |
| III | **Tarifa** | | - | - |
| 1 | Tarifë (për qëllime biznesi) për zënien dhe përdorimin e hapësirave publike | 1,500 | 1,500 | 2,182 |
| 2 | Tarifë për reklama | | - | - |
| 3 | Tarifë për parkim (për zënien dhe përdorimin e hapësirave publike për parkim) | 8,000 | 8,000 | 8,442 |
| 4 | Tarifa pastrimi, higjene dhe ndriçimi | 133,279 | 133,279 | 112,566 |
| 5 | Tarifë për therjen e bagetive | - | - | - |
| 6 | Tarifë për lëshime vërtetime | 4,000 | 4,000 | 500 |
| 7 | Tarife vendore per dhenie leje mjedisore | | - | 10 |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | ***Shuma III*** | ***146,779*** | **146,779** | **123,701** |
| ***IV*** | ***Të ardhura të tjera*** | | - | - |
| *1* | Qera ndërtese | 8,250 | 8,250 | 7,133 |
| *2* | Qera toke bujqësore & asete | 5,190 | 5,190 | 3,442 |
| | ***Shuma IV*** | ***13,440*** | **13,440** | **10,575** |
| ***V*** | ***Taksa, tarifa & të ardhura të tjera*** | | - | - |
| *1* | Të tjera | 82,810 | 82,810 | 16,802 |
| *2* | Të ardhura me destinacion (pullat gj.civile) | | - | - |
| *3* | Të ardhura nga shërbimi MZSH | 1,000 | 1,000 | 836 |
| *4* | Sponsorizime nga organizata jo qeveritare | | - | 2,138 |
| | ***Shuma V*** | ***83,810*** | **83,810** | **19,776** |
| | ***Bashkia (I+II+III+IV+V)*** | ***613,839*** | **613,839** | **494,407** |
| | ***Qendra Arsimit*** | ***12,240*** | **12,240** | **13,332** |
| *1* | Të prindërve për kopshtet e fëmijëve | 11,840 | 11,840 | 13,189 |
| *2* | Të prindërve për konvikte | 300 | 300 | 142 |
| *3* | Të tjera | 100 | 100 | 1 |
| | ***Ndërmarrja e Pasurise Publike*** | ***13,000*** | **13,000** | **6,131** |
| *1* | Të ardhura nga vaditja | 10,000 | 10,000 | 2,179 |
| *2* | Të tjera+te ardhura nga parkingu =197 | 3,000 | 3,000 | 3,951 |
| | ***Qendra Kulturore & Klubi i Sportit*** | ***1,500*** | **1,500** | **23.7** |
| | ***TOTALI (Bashki+3 nd/jet)*** | ***640,579*** | **640,579** | **513,893** |

*Shënim: Gjatë muajit dhjetor të vitit 2025 janë mbledhur nga agjenti tatimor Shoqeria Rajonale Ujesjelles Kanlizime Lushnje taksat dhe tarifat vendore në vlerën 5,836,431.31 lekë të cilat nuk janë xhiruar gjatë vitit 2025.*


2011
172,544,000
2012
161,835,000
2013
159,883,000
2014
175,544,000
2015
310,655,000
2016
362,482,000
2017
348,384,000
2018
370,927,000
2019
395,974,000
2020
413,773,000
2021
419,249,000
2022
437,372,000
2023
487,791,000
2024
520,540,000

***Grafiku 1. Paraqitja grafike e taksave dhe tarifave vendore nder vite***




-Në total, për vitin 2025, të ardhurat nga taksat dhe tarifat vendore të Bashkisë Lushnje përfshirë dhe Njësitë administrative Kolonjë, Bubullim, Krutje Allkaj, Fiershegan, Karbunarë e vogel, Hysgjokaj, Ballagat, Golem, Dushk, është realizuar në shumën 515,768,000 lekë kundrejt planit vjetor pre *640,579,000* lekë ose 80.52 %.

Në tabelen e mësiperme totoali i të ardhurave në vlerën 513,893,000 lekë nuk janë perfshirë të ardhurat nga zhdemtimet (kod ekonomik 7115600) dh të ardhurat nga privatizimet (kod ekonomik 7109903) në vlerën 1,875,000 lekë, të ardhura të cilat arkëtohen nga Bashkia Lushnje por që shkojnë pë llogari të Buxhetit Qendror. Vlera totale e të ardhurave është 515,768,000 lekë sic paraqitet edhe në grafiket e mësiperm.

Nga të dhënat e pasqyrës së mësipërme shohim se plani vjetor i të ardhurave të vitit 2025 është realizuar në masën 80.52 %, me një mosrealizim n shumën 124,811,000 lekë. Peshën më të madhe në këtë mosrealizim kryesisht e kanë Taksa mbi token Bujqesore,Taksa e ndikimit në Infrastrukturë Taksa e ndërtesës,Taksa e kalimit të drejtës së pronesise etj..Gjithashtu gjatë muajit dhjetor të vitit 2025 janë mbledhur nga agjenti tatimor Shoqeri Rajonale Ujesjelles Kanlizime Lushnje taksat dhe tarifat vendore në vlerën 5,836,431.31 lekë të cilat nuk janë xhiruar gjatë vitit 2025.Te dhenat mesiperme flasin për një nivel përafërsisht të njëjtë të të ardhurave tatimore për vitin 2025, në krahasim me vitet 2011-2024.






**Figura 3. Procesi i grumbullimit dhe shperndarjes se taksave dhe tarifave vendore ne Bashkine Lushnje**


**Grafiku A1.** *Pesha specifike e e taksave dhe tarifave vendor në vitin 2025.*




Për të kuptuar më mirë strukturën e të ardhurave të veta dhe performancën e bashkise në vite, para dhe pas reformës administrative dhe territoriale mund ti referohemi grafikut 1. Kontribuuesit kryesorë të rritjes së të ardhurave vendore janë taksa mbi pasurinë e paluajtshme, tarifat e shërbimeve t largimit të mbetjeve, ndriçimit publik dhe gjelbërimit, tarifat administrative dhe taksa e ndikimit në infrastrukturë .

- **TAKSA MBI PASURINË E PALUAJTSHME.**

***Grafiku A:Realizimi I taksës mbi pasurinë e paluajtshme (2011-2024)***





| VITI | Taksë Ndertese | Taksë Ndertese (Agjenti UKL) | Taksë Trualli (Agjenti UKL) | Takse toke Bujqesore | Taksa Truallit |
|---|---|---|---|---|---|
| 2011 | 13,890,000 | 0 | 0 | 1,968,000 | 0 |
| 2012 | 16,516,000 | 0 | 0 | 3,679,000 | 0 |
| 2013 | 17,795,000 | 0 | 0 | 3,764,000 | 0 |
| 2014 | 33,853,000 | 0 | 0 | 6,424,000 | 0 |
| 2015 | 53,471,000 | 0 | 0 | 46,241,000 | 0 |
| 2016 | 69,795,000 | 0 | 0 | 66,464,000 | 8,705,000 |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| 2017 | 66,284,000 | 0 | 0 | 46,964,000 | 10,392,000 |
| 2018 | 58,152,000 | 0 | 0 | 54,049,000 | 11,030,000 |
| 2019 | 83,250,000 | 8,044,201 | 395,493.33 | 44,078,000 | 15398000 |
| 2020 | 72,181,000 | 9,654,416 | 455,105 | 58,439,000 | 17,052,000 |
| 2021 | 69,009,000 | 16,972,599 | 771,788 | 58,047,000 | 18,695,000 |
| 2022 | 68,589,000 | 24,829,215 | 1,144,815 | 45,904,000 | 19,774,000 |
| 2023 | 80,272,000 | 29,567,202 | 1,356,447 | 60,589,000 | 22,106,000 |
| 2024 | 91,270,000 | 25,268,161 | 1,167,584 | 69,376,000 | 21,350,000 |
| 2025 | 86,019,000 | 25,311,906 | 1,175,931 | 65,640,000 | 20,257,000 |

## A. TAKSA MBI NDËRTESËN

Në vitin 2025, janë parashikuar te ardhura nga taksa në vlerën 97,000,000 lekë,dhë është realizuar në 86,019,000 lekë në masen 88.68% ,vlenë për t theksuar qe me VKB Nr.103 datë 26/11/2024 UKL është caktuar agjent tatimor për arkëtimin e Taksës së Ndërtesës. Në këtë parashikim përfshihe të ardhurat nga kategoria familjare dhe kategoria e biznesit, si me poshtë:

| | Parashikimi 2025 |
|---|---|
| **Taksa mbi pasurinë e paluajtshme (NDERTES)** | **97,000,000** |
| - Familjarët | 42,083,000 |
| - Subjektet Tregtare | 54,917,000 |





Grafiku A2 paraqet realizimin e të ardhurave nga taksa mbi pasurinë e paluajtshme ndertesa 2011-2025.

## TE ARDHURAT NDER VITE NGA TAKSA E NDERTESES

| | 2011 | 2012 | 2013 | 2014 | 2015 | 2016 | 2017 |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Taksë ndërtese | 13,890,000 | 16,516,000 | 17,795,000 | 33,853,000 | 53,471,000 | 69,795,000 | 66,284,000 |

| 2018 | 2019 | 2020 | 2021 | 2022 | 2023 | 2024 | 2025 |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 58,152,000 | 83,250,000 | 72,181,000 | 69,009,000 | 68,589,000 | 80,272,000 | 91,270,000 | 86,019,000 |

***Grafiku A2. Paraqitja grafike e takses se nderteses nder vite***




**Vlera 27,314,542.25 lekë është arkëtuar nga UKL ,por nuk eshte kryer kalimi i shumes per llogari te Bashkise Lushnje deri më atë 31.12.2025*

Nga të dhënat e pasqyrës së mësipërme shohim se plani vjetor i të ardhurave të vitit 2025 eshte realizuar 86,019,000 lekë në masën 88.68 %, me nj mosrealizim në shumën 10,981,000 lekë. Peshën më të madhe në këtë mosrealizim kryesisht e kanë taksa e ndërtesës per familjaret në Njësit Administrative,pasi nuk kanë kontratë furnizimi me UKL , si dhe ndikim në mos realizim ka patur dhe kategoria e taksapaguesve biznes, per shka te ndryshimeve ligjore te fundvitit 2017 dhe fillim vitit 2018, ku ndryshoj dhe menyra e taksimit nga siperfaqje $m^2$ x cmim , ne cmim reference os vlere prone.

## B. TAKSA MBI TOKËN BUJQËSORE

Baza e taksës mbi tokën bujqësore është sipërfaqja e tokës bujqësore, në hektar, në pronësi të taksapaguesit. Sipërfaqja e tokës në pronësi përcaktoh sipas dokumenteve që e vërtetojnë atë. Për çdo kategori minimale të tokës bujqësore, këshilli bashkiak mund të miratojë nënkategorizime. Si rezult i reformes administrativo – territoriale, Bashkise Lushnje i jane shtuar edhe siperfaqe toke bujqesore qe shtrihen ne hapsirat e njesive administrativ (ish komunave) .

Në vitin 2025, janë parashikuar të ardhura nga taksa në vlerën 100,000,000 lekë,dhe është realizuar në 65,640,000 lekë në masën 65.64% n mosrealizim 34,360,000 lekë .
Parashikimi i të ardhurave nga taksë mbi tokën bujqesore për vitin 2025, është si më poshtë:

REALIZIMI NDER VITE I TAKSES SE TOKES BUJQESORE


| Parashikimi 2025 | |
|---|---|
| Taksa mbi tokën Bujqësore | 74,277,360 |
| Detyrime të prapambetura | 25,722,640 |
| TOTALI | 100,000,000 |

| | *Sip/ HA Lushnje* | *Sip/ HA Nj.Allkaj* | *Sip/ HA Nj. Ballagat* | Sip/ HA Nj. Bubullime | *Sip/ HA Nj. Dushk* | Sip/ HA Nj. Fiershegan | *Sip/ HA Nj.Golem* | *Sip/ HA Nj. Hysgjokaj* | *Sip/ HA Nj. Karbunar* | *Sip/ HA Nj.Krutje* | *Sip/ HA Nj. Kolonje* | *Cmimi / Ha* | *PLANI/ Leke* |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| *Kat I-re* | 2.76 | 92.2 | 0 | 0 | 7 | 0 | 60 | 0 | 1 | 61 | 8.7 | *3920* | *912,027* |
| *Kat II-re* | 313.8 | 497.9 | 0 | 180.3 | 1568 | 72 | 800 | 9.4 | 2.3 | 1063 | 282.1 | *3430* | *16,425,584* |
| *Kat III-re* | 2508 | 1198.6 | 0 | 1787.3 | 261 | 1176 | 100 | 453.1 | 128.6 | 2146 | 1250 | *2940* | *32,365,284* |
| *Kat IV-re* | 625.3 | 0 | 0 | 849.1 | 687 | 533 | 700 | 683.6 | 402 | 382 | 964.3 | *2520* | *14,682,276* |
| *Kat V-re* | 125.9 | 0 | 5.9 | 11.3 | 448 | 244 | 750 | 50 | 495 | 46 | 233.8 | *2100* | *5,060,790* |
| *Kat VI-re* | 0 | 0 | 70.5 | 0 | 10 | 196 | 220 | 36 | 782.1 | 43 | 0 | *1680* | *2,280,768* |
| *Kat VII-re* | 0 | 0 | 1102.3 | 0 | 0 | 154 | 70 | 0 | 663 | 35 | 0 | *1260* | *2,550,618* |
| *Kat VIII-re* | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | *1260* | *0* |
| *Kat IX-re* | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | *1260* | *0* |
| | | | | | | | | | | | Totali | | *74,277,347* |

***Tabela e mëposhtme paraqet sipërfaqen e tokës, numrin e familjeve të trajtuara me tokë nga ligji 7501, etj., sipas njësive administrative, në hektar***

| Emërtimi | Nr. i fshatrave për çdo njësi | Sipërfaqja e tokës së ndarë | Sipërfaqja e tokës së dhënë me qira | Nr. i familjeve të trajtuara me tokë sipas ligjit 7501 | Sipas Regjistrit të Gjendjes Civile | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | **Nr. Popullsisë** | **Nr. Familjeve** |
| **Lushnje** | 5 Njësi | 3407.62 | 0 | 3548 | 54794 | 17829 |
| **Njësia Admin. Kolonje** | 9 | 2731.3 | 45.259 | 1890 | 8505 | 2386 |
| **Njësia Admin. Bubullimë** | 7 | 2862 | 0 | 1362 | 7197 | 2043 |
| **Njësia Admin. Krutje** | 11 | 4901.4 | 0 | 2501 | 10354 | 2554 |
| **Njësia Admin. Allkaj** | 5 | 1884 | 0 | 1103 | 6350 | 1548 |
| **Njësia Admin. Fiershegan** | 12 | 2345 | 0 | 1688 | 9774 | 2435 |
| **Njësia Admin. Karbunar** | 10 | 2474 | 0 | 1144 | 5664 | 1455 |
| **Njësia Admin. Hysgjokaj** | 5 | 1250 | 0 | 630 | 3634 | 966 |
| **Njësia Admin. Ballagat** | 8 | 1414.2 | 0 | 721 | 3825 | 1024 |
| **Njësia Admin. Golem** | 6 | 2700 | 16.748 | 1903 | 7856 | 2043 |
| **Njësia Admin. Dushk** | 7 | 2981 | 0 | 2875 | 12162 | 3114 |
| **SHUMA** | | **28950.52** | **62.007** | 19.365 | **130,115** | 37.397 |

***Grafiku A3.*** *Paraqitja grafike e takses se tokës nder vite*




## Realizimi i Takses se tokes Bujqesore sipas Njesive Administrative

**TAKSE TOKE BUJQËSORE**

| Njësia | 2017 | 2018 | 2019 | 2020 | 2021 | 2022 | 2023 | 2024 | 2025 PLANI | 2025 Nr. Familjeve që kanë kryer pagesën | 2025 Fakti | 2025 Rea % |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| ALLKAJ | 2,984,870 | 3,915,147 | 2,815,346 | 6,036,671 | 3,519,030 | 3,291,823 | 6,366,838 | 5,201,336 | 7,530,552 | 732 | 6,746,488 | 89. |
| BALLAGAT | 1,150,273 | 1,989,027 | 1,267,764 | 1,535,975 | 1,370,176 | 883,205 | 1,062,584 | 2,363,719 | 2,046,156 | 369 | 2,459,175 | 120 |
| BUBULLIME | 5,284,958 | 6,525,814 | 5,455,026 | 7,618,955 | 6,331,886 | 5,743,379 | 6,315,630 | 8,439,726 | 10,820,424 | 1,090 | 7,396,967 | 68. |
| DUSHK | 4,487,709 | 5,978,163 | 4,593,928 | 5,963,926 | 9,887,921 | 6,090,303 | 7,677,512 | 7,426,911 | 11,931,600 | 1,046 | 7,306,496 | 61. |
| FIER SHEGAN | 3,853,905 | 3,987,097 | 2,597,490 | 2,814,898 | 2,123,452 | 6,222,889 | 5,579,595 | 5,503,200 | 8,190,528 | 722 | 6,702,642 | 81. |
| GOLEM | 5,429,427 | 6,849,623 | 4,372,659 | 7,275,716 | 7,174,649 | 4,814,146 | 5,369,457 | 5,336,268 | 9,519,048 | 1,049 | 7,328,136 | 76. |
| HYSGJOKAJ | 2,672,869 | 1,779,452 | 1,042,750 | 2,066,225 | 1,645,083 | 1,532,953 | 1,903,474 | 3,215,671 | 4,379,172 | 219 | 2,590,059 | 59. |
| KARBUNARE E VOGEL | 2,631,200 | 1,928,568 | 1,207,946 | 1,744,841 | 2,383,860 | 2,350,932 | 1,905,666 | 5,106,879 | 6,182,316 | 270 | 2,608,135 | 42. |
| KRUTJE | 7,872,535 | 7,149,215 | 6,374,743 | 9,037,723 | 9,070,448 | 5,622,573 | 11,402,268 | 10,780,830 | 15,308,616 | 1,160 | 9,368,615 | 61. |
| KOLONJE | 5,287,522 | 7,799,048 | 5,688,896 | 5,881,507 | 6,377,940 | 4,547,562 | 7,531,908 | 5,500,338 | 10,229,580 | 1,118 | 6,861,117 | 67. |
| LUSHNJE | 4,849,490 | 6,535,833 | 8,706,254 | 8,2346,61.8 | 8,054,166 | 4,762,011 | 5,819,682 | 10,373,871 | 13,869,024 | 1,078 | 6,268,720 | 45. |

*Grafiku A4. Paraqitja grafike e takses se tokes nder vite*




Mosrealizimi i treguesit të taksës tokes bujqesore per vitin 2025 , ka ardhur si pasojë e mosarkëtimit të kësaj takse nga kategoria 'familjarë', ng problemet ligjore te cilat ka prona (toka bujqesore) e cila ne shum zona nuk është e azhornuar dhe nuk eshte bërë menaxhimi,si dhe ndarja e pasuris te familjaret e tjerë përfitues sipas ligjit 7501, gjithashtu Sektori i Vleresimit dhe Regjistrimit , ka kryer informatizimin e te gjithe regjistrave t taksapaguesve te tokes Bujqesore , si dhe ka perditesuar te dhenat ne regjistër duke i plotësuar me Nr.ID dhe Datelindje. Problematike eshte fakti s pas përfundimit te punes per perditesim te dhenave rreth 40 % e taksapaguesve nuk jane perditesuar te dhenat ,pasi nuk rezultojnë ne gjendje civil Ky fakt ndikon dhe ne pengimin e marrjes se masave per mbledhjen me force te detyrimeve..

### C. Taksa mbi truallin

Baza e taksës mbi truallin është sipërfaqja e truallit, në $m^2$, në pronësi apo përdorim të taksapaguesit. Sipërfaqja e truallit në pronësi përcaktohet sipa dokumenteve që e vërtetojnë atë. Në rast të mungesës së dokumentacionit të pronësisë, përdoruesi i truallit bën një vetdeklarim të sipërfaqes së truall në përdorim. Niveli i taksës caktohet në lekë për metër katror në vit. Detyrimi i taksës llogaritet si shumëzim i nivelit të taksës me bazën e tatueshm

Në vitin 2025, janë parashikuar të ardhura nga taksa në vlerën 20,400,000 lekë,dhe është realizuar në 20,257,000 lekë në masen 99.30 %.

Mungesa e informacionit mbi të ardhurat e kësaj takse mund të lidhet me probleme të mungesës pothuajse totale të regjistrave të bazës së taksës pë këtë taksë. Në këtë drejtim, një vlerësim më i thellë sugjerohet të kryhet nga autoritetet fiskale.

Parashikimi i të ardhurave nga taksë mbi truallin për vitin 2025, është si më poshtë:

**Viti 2025**

| | *Sip/ HA Lushnje* | *Sip/ HA Nj.Allkaj* | *Sip/ HA Nj.Ballagat* | *Sip/ HA Nj.Bubullime* | *Sip/ HA Nj.Dushk* | *Sip/ HA Nj.Fiershegan* | *Sip/ HA Nj.Golem* | *Sip/ HA Nj.Hysgjokaj* | *Sip/ HA Nj.Karbunar* | *Sip/ HA Nj.Krutje* | *Sip/ HA Nj.Kolonje* | *PLANI/ Leke* |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| *Siperfaqja* | *323.83* | 28.86 | 14.42 | 56 | 49 | 46.8 | 37.24 | 18 | 23.7 | 48.86 | 40.84 | *2,831,864* |
| *Cmimi / Ha* | 5600 | 2800 | 2800 | 2800 | 2800 | 2800 | 2800 | 2800 | 2800 | 2800 | 2800 | |
| *Totali* | 1,813,448 | 80,808 | 40,376 | 156,800 | 137,200 | 131,040 | 104,272 | 50,400 | 66,360 | 136,808 | 114,352 | |

**Të dhena të marra nga Drejtoria e Planifikimit të territorit në Bashkinë Lushnje.*


| | **Parashikimi 2025** |
|---|---|
| **Taksa mbi pasurinë e paluajtshme (TRUALL)** | **20,400,000** |
| - Familjarët | 2,831,864 |
| - Subjektet Tregtare | 17,568,136 |

## TE ARDHURAT NDER VITE NGA TAKSA MBI TRUALLIN

| | 2011 | 2012 | 2013 | 2014 | 2015 | 2016 | 2017 | 2018 | 2019 | 2020 | 2021 | 2022 | 2023 | 2024 | 2 |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Taksë Trualli | | | | | | 8,705,000 | 10,392,000 | 11,030,000 | 15,398,000 | 17,052,000 | 18,695,000 | 19,774,000 | 22,106,000 | 21,350,000 | 20,2 |
| Agjenti Tatimor UKL | | | | | | | | | | | | | | 1,167,584 | 1,17 |

**Vlera 1,263,217.75 lekë është arkëtuar nga UKL ,por nuk eshte kryer kalimi i shumes per llogari te Bashkise Lushnje deri më atë 31.12.2025*

***Grafiku A5. Paraqitja grafike e takses se truallit nder vite***





Nga të dhënat e pasqyrës së mësipërme shohim se plani vjetor i të ardhurave të vitit 2025 eshte realizuar në masën 99.30 %. Peshën më të madhe n
këtë realizim kryesisht e kanë taksa e truallit e cila aplikohet per taksapaguesit e kategorise biznes.

Realizimi i **Takses mbi truallin** sipas Njesive Administrative (FAMILJE)

## T\akse Trualli

| Njësia | 2018 | 2019 | 2020 | 2021 | 2022 | 2023 | 2024 | 2025 | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | | | | PLANI | Nr.Familjeve që kanë kryer pagesën | Fakti | Realizimi % |
| ALLKAJ | 103,662 | 116,897 | 139,350 | 117,879 | 127,156 | 142,582 | 131,707 | 126,000 | 204 | 140,091 | 111.18% |
| BALLAGAT | 32,131 | 39,030 | 51,332 | 47,091 | 45,747 | 39,452 | 61,862 | 29,676 | 161 | 60,936 | 205.33% |
| BUBULLIME | 188,525 | 194,249 | 189,700 | 181,481 | 171,448 | 172,097 | 193,822 | 156,804 | 74 | 170,632 | 108.81% |
| DUSHK | 155,040 | 159,806 | 189,418 | 344,322 | 221,413 | 254,845 | 275,300 | 137,196 | 564 | 284,697 | 207.51% |
| ER SHEGAN | 112,296 | 157,064 | 152,631 | 131,004 | 200,293 | 200,087 | 195,751 | 153,414 | 224 | 206,458 | 134.54% |
| OLEM | 237,917 | 157,876 | 191,210 | 182,346 | 157,349 | 171,762 | 194,930 | 104,268 | 216 | 201,393 | 193.21% |
| NGJOKAJ | 62,041 | 59,783 | 71,554 | 68,247 | 71,585 | 72,993 | 101,941 | 43,407 | 138 | 84,506 | 194.69% |
| KARBUNARE E VOGEL | 84,607 | 88,444 | 99,378 | 113,933 | 114,545 | 101,015 | 213,310 | 66,360 | 149 | 130,910 | 197.27% |
| KRUTJE | 205,658 | 230,465 | 214,802 | 228,326 | 193,940 | 203,268 | 229,485 | 280,116 | 220 | 200,729 | 71.65% |
| KOLONJE | 148,355 | 158,259 | 159,710 | 184,078 | 148,032 | 183,390 | 193,218 | 161,280 | 276 | 195,405 | 119.29% |
| | | | | | | | | | | | |
| LUSHNJE | 143,967 | 270,710 | 321,757.5 | 343,604 | 288,554 | 332,212 | 475,461 | 1,777,440 | 210 | 355,590 | 20% |

*Grafiku A6. Paraqitja grafike e takses se truallit nder vite (FAMILJE)*





**D. Tatimi i Thjeshtuar mbi Fitimin për Biznesin e Vogël.**

Në vitin 2025, janë parashikuar te ardhura nga tatimi në vlerën 0 lekë,dhe është realizuar në 439,000.

Realizimi i të ardhurave nga tatimi i thjeshtuar mbi fitimin për biznesin e vogël për vitet 2011-2025, është si më poshtë:

| | 2011 | 2012 | 2013 | 2014 | 2015 | 2016 | 2017 | 2018 | 2019 | 2020 | 2021 | 2022 | 2023 | 2024 | 2 |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| **Tatimi i Thjeshtuar mbi Fitimin për Biznesin e Vogël** | 38,400,000 | 40,771,000 | 33,319,000 | 31,766,000 | 53,663,000 | 11,166,000 | 5,030,000 | 3,376,000 | 3,529,000 | 4,562,000 | 3,226,000 | 862,000 | 661,000 | 653,000 | 43 |

***Grafiku A7.*** **Paraqitja grafike e Tatimi i Thjeshtuar mbi Fitimin për Biznesin e Vogël ndër vite**




Në bazë të ligjit nr.9920 datë 19.05.2008 "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë ï ndryshuar,Neni 15 ,***Zyrat tatimore të qeverisje vendore*** *.Zyrat tatimore të qeverisjes vendore funksionojnë dhe zbatojnë ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006, "Për sistemin e taksave vendore" dh administrojnë taksat, detyrimet tatimore dhe pagesat publike vendore, me përjashtim të tatimit të thjeshtuar mbi fitimin për biznesin e vogël. Drejtori e Përgjithshme e Tatimeve vlerëson, mbledh, kontrollon dhe arkëton tatimin e thjeshtuar mbi fitimin për biznesin e vogël. (Ndryshuar me Ligj N 179/2013, datë 28.12.2013. Botuar në Fletoren Zyrtare Nr. 203, datë 30.12.2013).*

Drejtoria Rajonale Tatimore Fier si dhe Drejtoria e të Ardhurave Vendore Bashkia Lushnje çdo muaj mbajn Akt-Rakordim për shpërndarjen e Tatim të thjeshtuar mbi fitimin ,në zbatim të Udhezimit Nr.32 datë 13.12.2013 "Për tatimin e thjeshtuar mbi fitimin e biznesit të vogël"I ndryshuar ,pika 1

### E. Taksa për fjetjen në hotel.


Taksa e fjetjes në hotel, bazohet në aktivitetin si motel, stabiliment turistik, pension, shtëpi pritjeje, turizëm familjar dhe çdo objekt tjetër me kë destinacion. Për vitin 2025 është parashikuar rivendosja e nivelit të taksës në 70 lekë sipas përcaktimeve në ligj, kjo dhe për faktin se ulja e nivelit taksës jo vetem që solli ulje të të ardhurave por dhe abuzime nga subjektet duke mos raportuar situatën reale të aktivitetit, kjo dhe për mungesën kontrollit sistematik nga strukturat pergjegjese.

Në vitin 2025 janë parashikuar të ardhura nga taksë në vlerën 180,000 lekë,dhe është realizuar 531,000 lekë në masën 295.19% me një tejkalim n shumen 351,000 lekë.

Realizimi i të ardhurave nga **Taksa për fjetjen në hotel** për vitet 2011-2025, është si më poshtë:

| | 2011 | 2012 | 2013 | 2014 | 2015 | 2016 | 2017 | 2018 | 2019 | 2020 | 2021 | 2022 | 2023 | 2024 | 2025 |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| **Taksa për fjetjen në hotel** | 27,000 | 61,000 | 75,000 | 45,000 | 70,000 | 80,000 | 126,000 | 221,000 | 348,000 | 149,000 | 313,000 | 356,000 | 535,000 | 420,000 | 531,000 |

***Grafiku A8. Paraqitja grafike e Taksa për fjetjen në hotel nder vite***



Nga të dhënat e pasqyrës së mësipërme shohim se plani vjetor i të ardhurave të vitit 2025 eshte realizuar në masën 295.19 %, me një tejkalim në shumën 351,000 lekë. Sensibilizimi i taksapaguesve ,duke i rikujtuar cdo muaj afatin e deklarimit qe eshte datra 5 e cdo muaji, si dhe përgatitja e formularëve te deklarimit, ka ndikuar pozitivisht. Gjithashtu dhe kontrolli i ushtruar vazhdimisht , per uljen e informalitetit ne kete sektor.

**F. Taksa e Ndikimit në Infrastrukturë nga ndërtimet e reja.**

Taksës së ndikimit në infrastrukturë nga lejet e ndërtimit i nënshtrohen të gjitha subjektet që kerkojnë të pajisen me leje zhvillimore për ndertim objekte banimi, administrative, prodhimi, shërbimi e tjera.

Në vitin 2025 janë parashikuar të ardhura nga taksë në vlerën 70,300,000 lekë, dhe është realizuar në vlerën 35,250,000 lekë, në masën 50.14 % me një mosrealizim në shumën 38,050,000 lekë.

Referuar nivelit të takses pritshmërisë së lejeve për shqyrtim e miratim (perfshire edhe ato të depozituara prej kohesh pranë Bashkisë Lushnje nga ndërtimet informale), për vitin 2025, parashikimi nga kjo taksë, paraqitet:


| | Parashikimi 2025 |
|---|---|
| **Taksa e Ndikimit në Infrastrukturë nga ndërtimet e reja** | **70,300,000** |

Në bazë të Vendimit të Keshillit Bashkiak Nr.102 datë 21/12/2021 "Për sistemin e taksave dhe tarifave vendore.Administrimin e tyre në Bashkinë Lushnjes dhe penalitetet për kundervajtjet administrative për vitin 2024", për planifikimin dhe ndjekjen e kësaj takse është ngarkuar Drejtoria e Planifikimit të Territorit në Bashki.

Realizimi i të ardhurave nga **Taksa e Ndikimit në Infrastrukturë nga ndërtimet e reja** për vitet 2011-2025, është si më poshtë:

| | 2011 | 2012 | 2013 | 2014 | 2015 | 2016 | 2017 | 2018 | 2019 | 2020 | 2021 | 2022 | 2023 | 2024 | 2 |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| **Taksa e Ndikimit në Infrastrukturë nga ndërtimet e reja** | 57,257,000 | 17,404,000 | 1,104,000 | 14,806,000 | 20,021,000 | 28,429,000 | 55,339,000 | 47,763,000 | 27,483,000 | 49,094,000 | 43,343,000 | 46,754,000 | 35,819,000 | 34,593,000 | 35,2 |

*Grafiku A9. Paraqitja grafike e Taksa e Ndikimit në Infrastrukturë nga ndërtimet e reja nder vite*




Nga të dhënat e pasqyrës së mësipërme shohim se plani vjetor i të ardhurave të vitit 2025 eshte realizuar në masën 50.14 %, me një mosrealizim n shumën 35,050,000 lekë.

Në zbatim të ligjit Nr. 9632, datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore"I ndryshuar , Neni 27 Taksa e ndikimit në infrastrukture , *pika 4. Këshil bashkiak miraton kategori dhe nënkategori për klasifikimin e investimeve, të cilat mund të përdoren për vendosjen e nivelit të taksës.*

**G. Taksa e kalimit të së drejtës së pronësisë për pasuritë e paluajtshme.**

Taksa mbi kalimin e të drejtës së pronësisë për pasuritë e paluajtshme vendoset për ndërtesat dhe të gjitha pasuritë e paluajtshme në çastin e kalim të së drejtës së pronësisë mbi to.

Në vitin 2025, janë parashikuar te ardhura nga takse ne vleren 10,000,000 lekë,dhe eshte realizuar ne 5,970,000 lekë ne masen 59.70 % ,me nj mosrealizim në shumën 4,030,000 lekë.

Bazuar në këto nivele të taksës janë kryer dhe kalkulimet për parashikimin e saj për vitin 2025 , si më poshtë:


| | Parashikimi 2025 |
|---|---|
| **Taksa e kalimit të së drejtës së pronësisë për pasuritë e paluajtshme** | **10,000,000** |

Realizimi i kësaj takse kryesisht nga strukturat e ASHK, agjent tatimor që përfiton edhe 3% të shumës së arketuar.

Realizimi i të ardhurave nga **Taksa e kalimit të së drejtës së pronësisë për pasuritë e paluajtshme** për vitet 2011-2025 është si më poshtë:

| | 2011 | 2012 | 2013 | 2014 | 2015 | 2016 | 2017 | 2018 | 2019 | 2020 | 2021 | 2022 | 2023 | 2024 | 2 |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| **Taksa e kalimit të së drejtës së pronësisë për pasuritë e paluajtshme** | 8,045,000 | 7,676,000 | 6,937,000 | 4,228,000 | 4,137,000 | 4,069,000 | 1,820,000 | 4,800,000 | 7,898,000 | 2,722,000 | 5,519,000 | 6,840,000 | 7,051,000 | 3,541,000 | 5,9 |

***Grafiku A10. Paraqitja grafike e Taksa e kalimit të së drejtës së pronësisë për pasuritë e paluajtshme nder vite***



Nga të dhënat e pasqyrës së mësipërme shohim se plani vjetor i të ardhurave të vitit 2025 eshte realizuar në masën 59.70 %, me një mosrealizim në shumën 4,030,000 lekë.

Në bazë të Vendimit të Këshillit Bashkiak Nr.103 datë 26.11.2024 "Për sistemin e taksave dhe tarifave vendore.Administrimin e tyre në Bashkinë Lushnjes dhe penalitetet për kundervajtjet administrative për vitin 2025", për planifikimin dhe ndjekjen e kësaj takse është ngarkuar Drejtoria Planifikimit të Territorit në Bashki.

Në zbatim të ligjit Nr. 9632, datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore"I ndryshuar , Neni 28 Taksa mbi kalimin e së drejtës së pronësisë për pasuritë e paluajtshme ,pika 4. Vjelja e kësaj takse bëhet nga zyrat e regjistrimit të pasurive të paluajtshme, të cilat, në rolin e agjentit të taksave përfitojnë 3 për qind të shumës së arkëtuar dhe diferencën e derdhin për llogari të buxhetit përkatës të bashkisë ose të , në territorin e së cilës ndodhe pasuria, jo më vonë se data 30 e muajit pasardhës. ASHK Lushnje, në të gjithë praktikën e ndjekur nuk ka mbajtur Akt-Rakordim,duke qënë se është detyrë ligjore e agjentit tatimor, për arkëtimin dhe shpërndarjen e kësaj takse me Bashkinë Lushnje

### H. Taksa për qarkullimin e mjeteve të përdorura

E ardhura nga taksa, mblidhet nga strukturat e Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor (Drejtoria Rajonale Fier) para kryerje së kontrollit teknik vjetor të detyrueshëm të mjetit. Procedura e ndarjes së të ardhurave me buxhetet e njësive të qeverisjes vendore përcaktohet m vendim të Këshillit të Ministrave, bazuar në numrin e mjeteve të regjistruara sipas njësive të qeverisjes vendore por e konvertuar në përqindje, n masën 25 % e të ardhurave vjetore mbasi është zbritur vlera e 5% që i takon agjentit tatimor DPSHTRR.

Në vitin 2025 janë parashikuar te ardhura nga takse ne vleren 36,000,000 lekë.dhe është realizuar në 59,414,000 në masën 165.04%,me nje tejkalim ne shumen 23,414,000 lekë


| | Parashikimi 2025 |
|---|---|
| **Taksa për qarkullimin e mjeteve të përdorura** | **36,000,000** |

Rakordimi i pagesës së taksës ndërmjet strukturave të DRSHTRR-së me organet tatimore të administratës qendrore dhe vendore kryhet në bazë t regjistrit ditor të taksës vjetore të mjeteve të përdorura, formati i të cilit është i përcaktuar me udhëzim të Ministrit të Financave.

Realizimi i të ardhurave nga **Taksa për qarkullimin e mjeteve të përdorura** për vitet 2011-2025, është si më poshtë:

| | 2011 | 2012 | 2013 | 2014 | 2015 | 2016 | 2017 | 2018 | 2019 | 2020 | 2021 | 2022 | 2023 | 2024 | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| **Taksa për qarkullimin e mjeteve të përdorura** | 11,457,000 | 16,637,000 | 13,454,000 | 10,739,000 | 20,236,000 | 20,882,000 | 21,831,000 | 30,240,000 | 35,501,000 | 37,864,000 | 40,471,000 | 44,335,000 | 49,273,000 | 52,621,000 | 59,4 |

***Grafiku A11. Paraqitja grafike e Taksa për qarkullimin e mjeteve të përdorura nder vite***




## I. Taksa e tabelës dhe reklamës.

Ndryshimet ligjore që sollën kthimin e taksave te tabelave në tarifa vendore duket të kenë sjellë efekte pozitive. Të ardhurat nga këto dy burime jan rritur nga 4,257,000 lekë në vitin 2011 në 14,135,000 lekë në vitin 2025, duke regjistruar kështu një rritje vjetore.
Vendosja e tabelës për qëllim identifikimi është detyrim për të gjithë subjektet, me përjashtim të ambulantëve, subjekteve të transportit dhe profesione e lira.

Taksa e tabelës përbëhet :

- Tabelë për qëllime identifikimi

- Tabele për qëllime reklamimi

Taksa e tabeles per qellime identifikuese ndahet ne:

- Tabelë për qëllime identifikimi:

- Tabelë për qëllime reklamimi e lëvizshme dhe e palëvizshme:

- Tabelë në funksion të ekspozimeve të ndryshme të hapura, panaire, spektakle, stenda reklamuese, banderola etj.

Mbështetur në realizimin e viteve të mëparshme por dhe në ecurinë e arkëtimit të kësaj takse, jane kryer edhe evidentimet mbi subjektet e kësaj taks


Në vitin 2025, janë parashikuar të ardhura nga taksë në vlerën 10,000,000 lekë,dhe është realizuar në 14,135,000 lekë në masën 123.18 % .

Konkretisht, kundrejt pritshmërisë së të ardhurave për vitin 2025, numrit te subjekteve të evidentuara dhe nivelit të taksës së miratuar sipas ligji realizimi i të ardhurave per vitin 2025, paraqitet në tabelën si më poshtë:


Realizimi i të ardhurave nga **Taksa e tabelës dhe rekla** për vitet 2011-2025, është si më poshtë:

| | 2011 | 2012 | 2013 | 2014 | 2015 | 2016 | 2017 | 2018 | 2019 | 2020 | 2021 | 2022 | 2023 | 2024 | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| **Taksë tabele** | 170,000 | 221,000 | 155,000 | 238,000 | 1,142,000 | 6,601,000 | 7,689,000 | 11,087,000 | 10,908,000 | 9,773,000 | 8,144,000 | 9,536,000 | 13,064,000 | 12,318,000 | 14, |
| **Takse Reklame** | 4,087,000 | 4,945,000 | 4,694,000 | 4,308,000 | 3,873,000 | 5,413,000 | 4,761,000 | 169,000 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | |

***Grafiku A12. Paraqitja grafike e Taksa e tabelës dhe reklamës ses nder vite***
***Pasqyrimi grafik per taksen e Tabeles***




***Grafiku A13. Pasqyrimi grafik per taksen e reklamës***




Nga të dhënat e pasqyrës së mësipërme shohim se plani vjetor i të ardhurave të vitit 2025 eshte realizuar në masën 141.35 %, me një tejaklim n shumën 4,135,000 lekë .

Ndryshimet ligjore ne vitin 2025, ben dhe ndryshimin e zerit nga Takse Rekalme dhe Takse Tabele , ne një emertim te perbashket Taksë Tabele (sipa qëllimit te përdorimit).

### J. Tarifa për zënien e hapsirave publike.

Tarifa për zënien e hapësirave publike llogaritet për sipërfaqen në $m^2$ të shfrytëzuar nga subjekti për ushtrimin e aktivitetit e indeksuar sipas zonës së vendndodhjes dhe nivelit të taksës për njësi të miratuar nga Këshilli Bashkiak e cila përbëhet nga:

- Zënia e hapsirës publike me kangjella, platforma, vazo etj
- Zenia e hapsires publike në tregjet publike.
- Zenia e hapsires publike për organizimin e spektakleve ose panaireve të ndryshme.


Mbi ketë bazë janë parashikuar edhe të ardhurat e kësaj tarife për vitin 2024, është si më poshtë:

| | **Parashikimi 2025** |
|---|---|
| **Tarifa për zënien e hapsirave publike** | **1,500,000** |

Realizimi të ardhurave nga **Tarifa për zënien e hapsirave publike** për vitet 2011-2025, është si më poshtë:

| | 2011 | 2012 | 2013 | 2014 | 2015 | 2016 | 2017 | 2018 | 2019 | 2020 | 2021 | 2022 | 2023 | 2024 | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| **Tarifa për zënien e hapsirave publike** | 349,000 | 1,403,000 | 1,152,000 | 992,000 | 1,753,000 | 1,323,000 | 1,222,000 | 1,093,000 | 1,702,000 | 1,101,000 | 1,662,000 | 1,336,000 | 2,195,000 | 2,743,000 | 2,1 |

*Grafiku A14. Paraqitja grafike e Tarifa për zënien e hapsirave publike nder vite*





Në bazë të Vendimit të Keshillit Bashkiak Nr.103 datë 26.11.2024 "Për sistemin e taksave dhe tarifave vendore.Administrimin e tyre në Bashkinë Lushnjes dhe penalitetet për kundervajtjet administrative për vitin 2025", si dhe mbështetur në realizimin e viteve të mëparshme por dhe në ecurinë arkëtimit të kësaj takse, jane kryer edhe evidentimet mbi subjektet e kësaj tarife.

## K. Tarifa e Pastrimit ,Ndricimit,Gjelberimit.

Tarifës së Pastrimit i nënshtrohen të gjithë familjet, personat fizikë ose juridikë, vendas ose të huaj, që banojnë dhe ushtrojnë veprimtari ekonomik brenda territorit të Bashkisë së Lushnje. Referuar realizimit te kesaj tarife nder vite dhe kapacitetit te taksapaguesve, edhte gjykuar te te kemi nje rrit te te ardhurave per kete tarife.

Mbi këtë bazë janë parashikuar edhe të ardhurat e kësaj tarife për vitin 2025, është si më poshtë:

| | Parashikimi 2025 |
|---|---|
| **Tarifa e Pastrimit ,Ndricimit,Gjelberimit** | **133,279,000** |
| -Familjaret | 79,967,400 |
| -Subjektet tregtare | 53311,600 |





Në vitin 2025, janë parashikuar të ardhura nga tarifë në vlerën 133,279,000 lekë,dhe është realizuar në 112,566,000 lekë në masën 84.46 % ku esh caktuar SHRUKL si agjent tatimor për arketimin e Tarifes se Pastrimit per te gjithe taksapaguesit te cilet kane kontrate per furnizimin me uje.

**TABELA 10 . TE ARDHURAT NDER VITE NGA Tarifa e Pastrimit, Ndricimit,Gjelberimit**

| 128 | 2011 | 2012 | 2013 | 2014 | 2015 | 2016 | 2017 | 2018 | 2019 | 2020 | 2021 | 2022 | 2023 | 2024 | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Tarifa e Pastrimit ,Ndricimit, Gjelberimit | 14,819,000 | 28,883,000 | 29,983,000 | 40,348,000 | 50,619,000 | 81,335,000 | 77,023,000 | 93,111,000 | 100,855,000 | 95,631,000 | 91,934,000 | 91,015,000 | 104,357,000 | 128,669,000 | 11 |
| Agjenti tatimor | | | | | | | | | | | | | | 36,834,700.98 | 3 |

***Shuma 35,510,982.31 lekë eshte shumë të cilën UKL nuk është e ka xhiruar brenda dates 31.12.2024 per llogari të bashkise.**

***Grafiku A15. Paraqitja grafike e Tarifa e Pastrimit ,Ndricimit,*Gjelberimit *nder vite***





Parashikimi të ardhurave nga subjektet e biznesit është mbështetur në kapacitet e taksapaguesve që perfaqesonë numrin e subjekteve të evidentua aktiv dhe nivelit të tarifes për vitin ushtrimor, të ardhura që trajtohen nga strukturat e Drejtorisë të Ardhurave Vendore, që në bashkepunim me njesi administrative kanë kryer në kohe njoftimet e subjekteve për detyrimin por në veçanti të ndjekin dhe mbedhjen e tyre. Tarifa e pastrimit për kategori familjare do te vijoj të arkëtohet nga Ujësjellës Kanalizime Sh.a, i cili aktualisht ka evidentuar një numer rreth 23,000 familje, efektivisht të mundshm për tu kontraktuar dhe arketuar tarifen e pastrimit, me nivele të diferncuara për qytetin dhe njesitë administrative, duke marrë në konsideratë edh lehtesirat fiskale për kategoritë që plotësojnë kushtet e VKB, për përjashtim nga pagesa e saj.


Realizimi i Tarifa e Pastrimit dhe largimit të mbeturinave nga Familjet sipas Njesive Administrative

## TARIFE PASTRIMIT DHE LARGIMIT TË MBETURINAVE

| Njësia | 2018 | 2019 | 2020 | 2021 | 2022 | 2023 | 2024 | 2025 | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | | | | PLANI | Nr. Familjeve që kanë kryer pagesën | Fakti | Realizim % |
| ALLKAJ | 1,068,509 | 1,131,313 | 1,621,329 | 1,323,404 | 1,181,152 | 1,500,344 | 1,690,306 | 1,866,000 | 213 | 1,779,078 | 90.58% |
| BALLAGAT | 215,882 | 240,115 | 313,242 | 357,402 | 297,329 | 221,135 | 466,802 | 507,504 | 149 | 438,996 | 91.98% |
| BUBULLIME | 1,566,569 | 1,801,046 | 2,040,482 | 2,028,831 | 1,569,050 | 1,671,250 | 2,306,910 | 1,897,200 | 134 | 2,051,381 | 121.60% |
| DUSHK | 1,469,144 | 1,415,861 | 1,850,604 | 3,612,623 | 2,117,312 | 2,359,662 | 2,909,628 | 3,340,800 | 673 | 3,012,642 | 87.09% |
| FIER SHEGAN | 1,515,236 | 1,687,837 | 1,766,440 | 1,355,135 | 2,474,519 | 2,457,706 | 2,541,705 | 2,064,000 | 257 | 2,895,569 | 123.14% |
| GOLEM | 1,375,654 | 1,288,580 | 2,000,488 | 1,961,292 | 1,408,927 | 1,553,255 | 1,871,987 | 2,234,400 | 231 | 2,092,482 | 83.78% |
| HYSGJOKAJ | 197,781 | 205,189 | 358,938 | 319,420 | 352,901 | 282,502 | 494,172 | 397,596 | 150 | 433,291 | 124.29% |
| KARBUNARE E VOGEL | 340,904 | 305,698 | 348,218 | 375,629 | 428,898 | 254,045 | 841,195 | 979,296 | 144 | 620,48 | 85.90% |
| KRUTJE | 2,065,087 | 2,301,095 | 2,273,855 | 2,456,169 | 1,874,029 | 1,834,542 | 2,667,503 | 2,325,600 | 235 | 2,502,903 | 114.70% |
| KOLONJE | 1,691,290 | 1,754,666 | 1,885,781 | 2,445,860 | 1,555,796 | 2,200,440 | 2,465,543 | 2,744,400 | 495 | 2,568,10 | 89.84% |
| LUSHNJE | 26,544,439 | 27,259,877 | 29,277,895.10 | 29,062,615 | 27,429,578 | 29,180,934 | 35,149,397 | 39,182,400 | 451 | 26,904,208 | 89.71% |

***Grafiku A16. Paraqitja grafike e Tarifa e Pastrimit nga familjet sipas Njesive***






